



Transoilgroup Sh. A

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015**

EY

Përmbajtja

OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.....	2
PAQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL.....	3
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE.....	4
1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM.....	5
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE.....	5
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE (VAZHDIM).....	6
3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME.....	7
4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË.....	11
5. INVENTARI.....	11
6. LLOGARITË E ARKËTUESHME.....	11
7. TVSH E ARKËTUESHME.....	11
8. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALË TË LIDHURA.....	11
9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA.....	11
10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE.....	12
11. DETYRIMET AFATAGJATA.....	13
12. HUAMARRJET.....	13
12. HUAMARRJET (VAZHDIM).....	14
13. LLOGARI TË PAGUESHME.....	14
14. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA.....	14
15. KAPITALI AKSIONAR.....	14
16. TË ARDHURAT.....	14
17. SHPENZIME PËR MATERIALE.....	15
18. SHPENZIME PERSONELI.....	15
19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE.....	15
20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA.....	16
21. TË ARDHURA FINANCIARE.....	16
22. SHPENZIMET FINANCIARE.....	16
23. TATIM FITIMI.....	16
23. TATIM FITIMI (VAZHDIM).....	17
24. PALËT E LIDHURA.....	17
25. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË.....	18
26. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT.....	18

OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar aksionarëve të Transoilgroup sh.a

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të Transoilgroup sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

Përgjegjësia e audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, si dhe të performancës financiare dhe të flukseve monetare të saj për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.5 të pasqyrave financiare ku shpjegohet ndikimi negativ nga rënia e çmimit të naftës dhe gjykimin e drejtimit dhe hapave të ndërmarra për të mbuluar detyrimet financiare si dhe për të përmbushur angazhimet e saj investuese të kërkuara nga kontrata e konçesionit. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në këtë drejtim.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël i Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
18 korrik 2016
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar



Transoilgroup sh.a

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014	
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	3.380.149	2.223.722
Totali i aktiveve afatgjata		3.380.149	2.223.722
Aktive afatshkurtra			
Inventari	5	157.052	281.484
Llogari të arkëtueshme	6	22.051	8.201
TVSH e arkëtueshme	7	188.618	257.571
Te arkëtueshme nga palët e lidhura	8	-	242.619
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	11.964	5.853
Mjete monetare dhe depozita afatshkurtra	4	9.752	100.040
Totali i aktiveve afatshkurtra		389.437	895.768
TOTALI AKTIVEVE		3.769.586	3.119.490
Kapitali			
Kapitali aksionar	15	10.000	10.000
Humbja e mbartur		(2.341.117)	(1.940.761)
Totali i kapitalit		(2.331.117)	(1.930.761)
Detyrimet afatgjata			
Detyrime afatgjata	11	23.893	46.432
Huamarrjet afatgjata	12	2.468.660	2.291.638
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	24	3.210.882	2.345.016
Totali i detyrimeve afatgjata		5.703.435	4.683.086
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	13	278.574	258.159
Të ardhura të shtyra		6.290	-
Llogari të pagueshme të tjera	14	69.629	50.104
Huamarrjet afatshkurtra	12	42.775	58.902
		397.268	367.165
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONAR		3.769.586	3.119.490

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë më 24 qershor 2016.

Av. Shërfqet Dizdari

Administratori

Bernard Sylaj

Shef Kontabiliteti

Transoilgroup sh.a

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shitjet	16	747.838	740.694
Renta minerare		(74.784)	(73.987)
Të ardhurat neto		673.054	666.707
Shpenzimet për materiale	17	(314.712)	(312.794)
Ndryshimi i gjendjes së inventarit		(115.733)	50.575
Shpenzimet e personelit	18	(161.378)	(186.037)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	19	(194.281)	(250.505)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	10	(71.113)	(41.446)
Shpenzime të tjera, neto	20	(20.149)	(24.692)
Humbje nga veprimtaria operative		(204.312)	(98.192)
Të ardhura financiare	21	23.361	40.992
Shpenzime financiare	22	(219.405)	(275.850)
Humbja para tatimit		(400.356)	(333.050)
Tatim fitimi	23	-	-
Humbja neto		(400.356)	(333.050)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

PAQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	<u>Kapitali aksionar</u>	<u>Humbje e mbartur</u>	<u>Totali</u>
Më 1 janar 2014	10.000	(1.607.711)	(1.597.711)
Humbja neto për vitin	-	(333.050)	(333.050)
Më 31 dhjetor 2014	10.000	(1.940.761)	(1.930.761)
Humbja neto për vitin	-	(400.356)	(400.356)
Më 31 dhjetor 2015	10.000	(2.341.117)	(2.331.117)

Pasqyrat financiare të ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5–18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Humbja para tatimit	(400.356)	(333.050)
Rregullime për:		
Zhvlerësimet dhe amortizimet	10 71.113	47.836
Provizione afatshkurtër Albpetrol (Fitim)/Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata	13 49.752	43.812
	(391)	1.336.667
Fitimi operativ përpara rregullimeve në kapitalin punues	(279.882)	1.095.265
Rënia/ (Rritja) në llogaritë të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	6 291.611	(138.477)
Rënie/ (Rritja) në inventar	5 124.432	(41.394)
Rënia/ (Rritja) në llogarite e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	13,14 (512.301)	2.849.269
Rritja në llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura	24 1.352.106	(854.387)
Fluksi monetar i gjeneruar nga veprimtaria e shfrytëzimit	975.966	2.910.276
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit	10	
Blerje aktive afatgjata materiale	(1.228.633)	(1.576.725)
Nxjerrje jashte përdorimit te aktiveve afatgjata	1.484	(1.336.667)
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtaritë e investimit	(1.227.149)	(2.913.392)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit		
Hua të marra	12 160.895	-
Fluksi monetar neto në veprimtaritë e financimit	160.895	-
Rënia neto në mjete monetare dhe ekuivalentë	4 (90.288)	(3.116)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj më 1 janar	100.040	103.157
Mjete monetare dhe ekuivalente me 31 dhjetor	9.752	100.041

Pasqyrat e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-18 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

Transoilgroup sh.a ("Shoqëria") është themeluar më 22 nëntor 2011 sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me qendër në Tiranë. Shoqëria ka filluar aktivitetin gjatë vitit 2012 dhe nuk ka veprimtari të mëparshme. Që nga shkurti i 2012-ës Shoqëria është përfshirë në operacionet e kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri.

Shoqëria operon në Shqipëri në zonën naftëmbajtëse të Visokës sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve të shoqërisë mëmë Transoilgroup AG (Zvicër) dhe Albpetrol sh.a (Albpetrol), shoqëri në pronësi shtetërore nën liçencën ekzistuese të Albpetrol me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Marrëveshja e Visokës u bë efektive në Dhjetor 2008 dhe ka një kohëzgjatje prej 25 vitesh me mundësinë e zgjatjes së afatit, me kërkesë të Shoqërisë dhe aprovimin nga qeveria dhe entet regullatore.

Shoqëria më 31 dhjetor 2015 kishte të punësuar 149 punonjës (31 dhjetor 2014: 148 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2015.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, por USD është monedha funksionale e Shoqërisë.

Kurset zyrtare të këmbimit të monedhave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 sipas Bankës së Shqipërisë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
USD / LEK	125.79	115.23
EURO / LEK	137.28	140.14

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe raportimin e shumave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e nënvizuara rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e aktiviteteve të realizuara nga Shoqëria.

2.5 Vijueshmëria

Shoqëria është operatori në emër të shoqërisë mëmë të saj, Transoilgroup AG, për Licence Marrëveshjen me Ndarje Prodhimi të naftës ("MNP") midis Transoilgroup sh.a dhe Albpetrol sh.a, shoqëria shtetërore e naftës. Sipas kushteve të MNP-së, është e nevojshme që Shoqëria dhe shoqëria mëmë të bejnë shpenzime kapitale në fushën e naftës të cilat aprovohen nga AKBN dhe Albpetrol cdo vit financiar. Investimi ka për qëllim të përmirësojë pajisjet dhe infrastrukturën ekzistuese, shpimin e puseve të reja dhe rritjen e prodhimit të naftës së papërpunuar në nivele të qëndrueshme tregtare.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE (VAZHDIM)

2.5 Vijueshmëria (vazhdim)

Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje me Gaffney Cline & Associates, një kompani ndërkombëtare këshillimi mbi naftën, e cila ka kryer një vlerësim të rezervës së rikuperueshme në zonën naftëmbajtëse nëpërmjet metodave konvencionale. Raporti i Gaffney Cline & Associates paraqet se Rezervat e Naftës Bruto në zonën e Visokës depozituar në milionë fuci janë si më poshtë:

Të vërtetuara 1P - 37.51 milionë fuci

Të vërtetuara + Të mundshme 2P - 65.32 milionë fuci

Të vërtetuara + Të mundshme + Të mundura 3P - 119.90 milionë fuci

Si rezultat i këtij raporti, Manaxhimi është i bindur për qëndrueshmërinë afatgjatë të fushës së naftës në bazë të raportit të rezervës nga Gaffney, Cline & Associates dhe vlerësimeve shumë mira sipas Brent Price dhe kostove të parashikuara nga Transoilgroup sh.a. mund të thuhet se niveli i mjaftueshëm i investimeve kapitale është arritur.

Megjithatë, rënia e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare ka shkaktuar vështirësi të mëdha financiare dhe bën që investimet e reja për të rritur kapacitetet nxjerrjeje të jenë jo ekonomikisht të mundshme. Çmimi aktual i ulët i naftës është nën vlerësimet e parashikuara nga Gaffney, Cline & Associates dhe bën të vështirë që nivelet e kërkuara të investimeve kapitale të plotësohen nga Shoqëria.

Për këtë qëllim, kompania ka hyrë në një Marrëveshje shpuese Turnkey Drilling me Albdriking sh.a dhe Porto Romano Oil sh.a siç shpjegohet më poshtë, e cila do të mbështesë kërkesat e investimeve të kompanisë. Sipas Marrëveshjes shpuese Turnkey Drilling, çdo muaj Porto Romano Oil sh.a do të paguajë për të Transoilgroup sh.a shumën e barabartë me totalët e Capex-eve, OPEX-eve dhe shpenzimeve administrative që Transoilgroup sh.a planifikon të shpenzojë në atë muaj të veçantë. Deri në fund të vitit 2015 Albdriking sh.a. ka përfunduar shpimin e 10 puseve. Kostoja mesatare e një pusi është USD 2 milion. Sipas marrëveshjes, Albdriking sh.a. do të kompensohen me naftë bruto, dhe si rezultat i investimeve të reja kapitale bëhen nëpërmjet Marrëveshjes shpuese Turnkey, ky fakt nuk do të ndikojë negativisht në pasqyrën e flukseve monetare të kompanisë e as të kërkojë injeksione të reja të konsiderueshme kapitale në Shoqëri.

Më 24 dhjetor 2015, aksionerët e Shoqërisë, AKBN dhe Albpetrol mbajtën Takimin e Këshillit ku u ra dakord për planin e investimeve të Shoqërisë për vitin 2016. Këshilli ra dakord se në qoftë se çmimi i shitjes i naftës nuk do të arrijë mesatarisht USD 60/bbl Shoqërisa mund të shtyjë planin e investimeve kapitale për hapjen e puseve të reja dhe mund të mbajë nivelin e prodhimit të naftës me puset aktuale operative.

Me nivelin aktual të prodhimit nga puset ekzistuese dhe me një çmim Brent prej rreth USD 50/bbl, drejtimi vlerëson se do të ketë të hyra të mjaftueshme të mjeteve monetare për të përmbushur kërkesat e saj monetare, si dhe në natyrë (naftë) pjesë e detyrimeve ndaj Porto Romano.

Për më tepër nëpërmjet Marrëveshjes shpuese Turnkey Drilling, drejtimi i Kompanisë ka ndërmarrë një sërë hapash për të përmirësuar aftësinë e tij për të siguruar vijueshmërinë e biznesit në terma afatshkurtër dhe aftësinë e saj për të arritur investimet kapitale në terma afatgjatë dhe të bëjë fushën e naftës fitimprurëse si më poshtë:

- Porto Romano Oil, Albdriking kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për të mbështetur Shoqërinë të mbulojë shpenzimet operative.
- Porto Romano Oil ka nënshkruar gjitha pretendimet e saj aktuale dhe të ardhshme për dërgesa tretësi (Kërkesat Vartëse) kundër Transoilgroup sh.a për të gjitha borxhet e tjera aktuale ose të ardhshme të pasigurta të Transoilgroup sh.a ndaj të gjithë kreditorëve të tjerë.
- Të gjitha detyrimet e kompanisë mëmë drejt Bordit të Drejtorëve dhe Aksionarët kanë qënë gjithashtu në varësi dhe operacionet me selinë janë riorganizuar në mënyrë për të reduktuar ndjeshëm kostot.

Si rezultat i këtyre veprimeve, manaxhimi beson se nuk ka risqe materiale për Transoilgroup Albania sh.a. për të mos përmbushur detyrimet e tij që vijnë rrjedhimisht dhe se supozimi i vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare është i përshtatshëm.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve ku specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga këmbimi për zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Detyrimet që rrjedhin nga marrveshja Turnkey Drilling mes Shoqërisë dhe Porto Romano Oil sh.a. dhe Abdrilling sh.a. do të regjistrohen me kursin historik. Këto detyrime do të kompesohen me nafte bruto.

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, huamarrje, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, përveç instrumenteve jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrje

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Të tjerë

Instrumente të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.3 Aktivet Afatgjata Materiale

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e përlogaritur për mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme, huamarrjeve, duke zbritur çdo rënie në vlerë, përaftron me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga ku aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen për vlerën neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve fikse në aktivitetet e prodhimit të hidrokarbureve llogaritet duke përdorur metodën e njësisë-së-prodhimit duke iu referuar përqindjes së prodhimit në vit e lidhur me rezervat e vërtetuara dhe të mundshme, përveç në rastin e aktiveve, jeta e dobishme e të cilave është më e shkurtër se jeta e fushës, në të cilin rast metoda lineare është aplikuar.

Për aktivet të tjera, amortizimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar për çdo pjesë të aktiveve materiale afatgjata. Toka nuk amortizohet. Vlerësimi i jetës së dobishme, vlerës së mbetur dhe metodës së amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, me efektin e ndonjë ndryshimi të llogaritur.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat respektive të amortizimit janë si më poshtë: Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese.

Kategoritë kryesore të aktiveve fikse amortizohen me metodën lineare duke përdorur jetët e dobishme të mëposhtme:

Përmirësimet e objekteve me qera	më e vogla nga kohëzgjatja e qerasë ose jeta e dobishme
Mobilje dhe instalime	5-10 vite
Pajisje informatike dhe zyre	3-5 vite
Makineri	5-8vite

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.4 Inventari

Inventarët vlerësohen me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Kostoja përfshin të gjitha kostot e ndodhura në një situatë normale biznesi për sjelljen e inventarëve në vendodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e naftës së papërpunuara është kostoja e blerjes ose kostoja e prodhimit, duke përfshirë pjesën e zhvlerësimit, fros dhe amortizimit dhe të përgjithshme bazuar në kapacitetin normal. Kostoja llogaritet në bazën e peshës mesatare.

Vlera neto e realizueshme bazohet në vlerësimin me çmimit të shitjes në fund të vitit duke zbritur kostot e vlerësuar për kompletimin dhe përfundimit e shitjes.

3.5 Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiarë

Një aktiv financiar është konsideruar i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një apo më shumë ngjarje kanë pasur një efekt negativ mbi flukset monetare të ardhshme të atij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si ndryshim midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara që janë skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivët jo-financiarë

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi ose njërive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin e një shume dhe kohëzgjatje të pasigurt.

3.7 Kostot e çmontimit

Si pasojë e natyrës së aktivitetit, Shoqëria ka impakt në mjedis. Shoqëria synon të ndjekë praktikën më të mira për mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure, Shoqëria duhet që në fund të koncesionit të kthejë mjedisin në gjendjen e tij mëparshme. Drejtimi ka konkluduar se Shoqëria ka detyrim për të çmontuar vetëm makineritë dhe pajisjet e vendosura pas datës së marrjes në dorëzim të zonës naftëmbajtëse dhe jo të paisjeve që kanë qenë paraprakisht të vendosura. Detyrimi për çmontim matet me vlerën aktuale të vlerësimit më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të kërkuara për të shyer detyrimin në datën e bilancit.

Sipas Licencë Marrëveshjes me Ndarje Prodhimit, seksioni 3.9, Shoqëria duhet të paraqesë tek AKBN-ja 5 vite para përfundimit të Licencë Marrëveshjes një plan të detajuar mbi abandonimin e fushës për miratim nga AKBN.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)

3.8 Detyrimet të ripagueshme në natyrë

Detyrimet e ripagueshme në natyrë mund kryhen në dy mënyra. Shoqëria mund të marrë hua inventarë nga një palë tjetër si psh, Albpetrol ose të dorëzojë më pak naftë të papërpunuar tek Albpetrol sesa është e përcaktuar në Marrëveshjen e Hidrokarbureve. Bazuar në prodhim, ka dy lloj sasive naftë të papërpunuar të detyrueshme ndaj Albpetrolit:

- Të pagueshme në natyrë 70% të prodhimit, që pakësohet me 10% në vit, gjatë periudhës 6 mujore që pason menjëherë marrjen në dorëzim nga shoqëria të zonës naftëmbajtëse ("prodhimi i parashikuar");
- Prodhimi i mbetur do të ndahet më tej duke i kaluar në natyrë Albpetrolit një sasi (1%-6%) bazuar në rikuperimin e kostove ("sipas ndarjes së Albpetrol") dhe faktorit R.

Detyrimet në natyrë njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Detyrimet vlerësohen me më të voglën e vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë në datën e raportimit kundrejt njohjes fillestare. Për detyrimet ku Shoqëria është e detyruar t'i shlyej në mjete monetare, në çdo datë raportimi detyrimet vlerësohen me vlerën e drejtë duke marrë parasysh ndryshimet në vlerën e drejtë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave. Për detyrimet që duhet të shlyhen në natyrë, humbjet regjistrohen në periudhën e mëpasshme, kurse fitimet nuk regjistrohen.

3.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave gjatë aktivitetit normal maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose llogarive të arkëtueshme neto nga zbritjet dhe nga taksat e lidhura me shitjet.

3.10 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura nga interesi në llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat financiare njihen kur ato ndodhin. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes (nqs ekzistojnë) dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare

3.11 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Bazuar në ligjin shqiptar si dhe në Marrëveshjen e Hidrokarbureve, shoqëria, është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në normën 50%. Baza e tatueshme është "Fitimi nga Nafta" e cila është e përcaktuar sipas mekanizmit të faktorit R. Hidrokarburi i përfituar është pjesa e mbetur e sasisë totale të hidrokarburit të prodhuar në një periudhë të përcaktuar pasi është zbritur kostoja e hidrokarburit, e cila është pjesa e hidrokarburit të prodhuar që kontraktori ka të drejtë të përdorë për të mbuluar kostot e kapitalit dhe shpenzimeve operative, duke përfshirë 10% taksë minerare mbi të ardhurat nga shitja. Shpenzimet e interesit, dhurimet, gjobat, shpërblimet, shpenzimet e shpërndarja nga zyra qendrore që kalojnë përtej shumës së përcaktuar nga Marrëveshja e Përbashkët të Prodhimit, dhe shpenzime të tjera të paarsyeshme dhe të panevojshme për operacionet e hidrokarbureve janë të pa rikuperueshme. Shpenzimet e akumuluar gjatë fazës së kërkimit dhe zhvillimit janë totalisht të rikuperueshme pa qenë objekt i zhvlerësimit.

Kostot e përfundimit dhe restaurimit janë plotësisht të rikuperueshme me miratimin e vlerësimit nga AKBN, kostot e vlerësuara të përfundimit do të përfshihen në Kostot e Hidrokarbureve dhe mbulohen sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve dhe në kohën e dhënë në vlerësim.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË

Mjete monetare dhe ekuivalentë përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
<i>Arka</i>		
Mjete monetare në LEK	135	279
	135	279
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse në LEK	2.455	40.642
Llogari rrjedhëse në EUR	4	134
Llogari rrjedhëse në USD	7.152	58.985
Llogari rrjedhëse në CHF	6	-
	9.617	99.761
	9.752	100.040

5. INVENTARI

Inventari përbëhet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Naftë e papërpunuar	131.056	246.789
Materiale të tjera	25.298	23.951
Lënda tretëse	698	10.744
	157.052	281.484

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 janë 22.051 mijë Lekë dhe vijnë nga shitjet e naftës së papërpunuar drejt Kesi sh.a, Phoenix Petroleum sh.a dhe BP 2014.

Ndërsa më 31 dhjetor 2014 llogaritë e arkëtueshme ishin 8.201 mijë Lekë dhe lidhen me klientët kryesorë të Shoqërisë, Alodrilling sh.a, e cila është shoqëria e kontraktuar për shpimin e puseve horizontale.

7. TVSH E ARKËTUESHME

TVSH-ja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është e përbërë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
TVSH e arketueshme	503.581	499.300
TVSH e pagueshme	(314.963)	(241.729)
	188.618	257.571

Gjatë vitit 2015 shoqëria i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore në Tiranë me një Kërkesë për Rimbursim TVSH-je për shumën e TVSH-së së akumuluar gjatë viteve. Pas një kontrolli tatimor kjo kërkesë është miratuar duke ekzekutuar edhe rimbursimin përkatës gjatë vitit 2015.

8. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALË TË LIDHURA

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Porto Romano Oil Sh.A	-	242.619
	-	242,619

Gjatë vitit 2015 shoqëria ka arritur në një marrëveshje të netimit të detyrimit dhe të drejtave respektive me klient - furnitorët me të rëndësishëm siç është furnizuesi kryesor i holluesit Porto Roman Oil sh.a. dhe nënkontraktori i shpimeve horizontale Alodrilling sh.a.

9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Shpenzimet e parapaguara ndaj furnitorëve	6.861	203
Akciza	3.845	3.845
Parapagime të tjera	1.258	1.805
	11.964	5.853

10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbehen si më poshtë:

	Hidrokarburet	Mobilje dhe instalime	Pajisje informatike dhe zyre	Makinieri	Ndërtime në proces	Të tjera	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2014	587.573	2.309	7.498	33.935	82.398	8.752	722.465
Shtesa	893.033	3.962	544	6.592	670.751	1.843	1.576.725
Më 31 dhjetor 2014	1.480.606	6.271	8.042	40.527	753.149	10.595	2.299.190
Shtesa	1.149.866	40	275	4.813	70.885	2.754	1.228.633
Shifje	(1.093)	-	-	-	-	-	(1.093)
Transferime	661.885	-	-	-	(661.885)	-	-
Më 31 dhjetor 2015	3.291.264	6.311	8.317	45.340	162.149	13.349	3.526.730
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 janar 2014	17.083	437	1.453	8.401	-	258	27.632
Shpenzimi i periudhës	35.343	1.129	1.909	9.058	-	397	47.836
Më 31 dhjetor 2014	52.426	1.566	3.362	17.459	-	655	75.468
Shpenzimi i periudhës	57.295	1.322	2.026	10.002	-	468	71.113
Më 31 dhjetor 2015	109.721	2.888	5.388	27.461	-	1.123	146.581
Vlera kontabël neto më 31 dhjetor 2014	1.428.180	4.705	4.680	23.068	753.149	9.940	2.223.722
Vlera kontabël neto më 31 dhjetor 2015	3.181.543	3.423	2.929	17.879	162.149	12.226	3.380.149

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

11. DETYRIMET AFATAGJATA

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrimet afatgjata ndaj Albpetrol	23.893	46.432
	23.893	46.432

Pasi Shoqëria mori në kontroll zonën naftëmbajtëse, disa sasi të inventarit të hidrokarbureve të përpunuara, të cilat i përkisnin Albpetrol u lanë në magazine dhe në tuba dhe njihen nga Shoqëria si detyrim afatgjat ndaj Albpetrol sh.a. Kjo sasi do të rikthehet pasi Marrëveshja me Ndarje Prodhimit të rrezikohet.

Në vitin 2015 Shoqëria ka përllogaritur të tërë detyrimin ndaj Albpetrol për Prodhimi Para Ekzistues (PEP) dhe Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA) (në ton metrik (MT) (shënimi 14):

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrimi afatshkurtër në MT	2.811	1.275
Detyrimet Afatgjata në MT	1.350	1.350
	4.161	2.625

Detyrimi mund të zgjidhet në naftë ose me para në dorë. Gjatë vitit 2015 Shoqërisë i është rritur detyrimi ndaj Albpetrolit pasi ka lëvruar një sasi vetëm prej 3.640,24 MT. Kjo si pasojë e refuzimit për tërheqje të naftës nga Albpetrol për mungesë të kapaciteteve magazinuese nga ana e tyre.

Detyrimi i njohur matet në Brent dhe në kosto të naftës që është prodhuar, e cila është më e ulët se Brent. Diferenca e detyrimit i matur në Brent kundrejt shpenzimit të njohur duke përdorur koston e prodhimit të naftës, njihet nën zërin e shpenzimeve të tjera operative të paraqitura në shënimin shpjegues 20.

Provizioni i çmontimit lidhet me obligimin e Shoqërisë për zhvendosjen e aktiveve të veta dhe kthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme sipas Licence Marrëveshjes me Ndarje Prodhimit. Sipas kësaj marrëveshje seksioni 3.9, Shoqëria duhet të paraqesë tek AKBN 5 vite para përfundimit të Licence Marrëveshjes një plan të detajuar mbi abandonimin e fushës për miratim nga AKBN.

Në vitin 2015 kompania ka përllogaritur të tërë detyrimin për PPE dhe PPA 2.811,27 ton metrik (MT) (2014: 1.274,98 MT) të matur me çmimin në Brent të 31 dhjetor 2015 (shënimi 11, 14), dhe e ka njohur atë në pasqyrën e të ardhurave.

Detyrimi mund të shlyhet ose me para në dorë bazuar në çmimet aktuale Brent ose në naftë bruto. Shoqërisë i është rritur detyrimi ndaj Albpetrol gjatë vitit 2015 dhe ka lëvruar 3.640,27 MT naftë e cila njihet si kosto.

12. HUAMARRJET

Hua nga palët e lidhura

Në 30 qershor 2014 Shoqëria nënshkroi një marrëveshje huaje pa interes me Transoilgroup AG për USD 20.717.879 (përfshirë USD 6 milion) ose 1.695.941 mijë Lekë. Deri me 31 dhjetor 2015 Shoqëria ka paguar USD 868.336

Qiraja financiare

Në 29 Qershor 2012 Shoqëria nënshkroi një marrëveshje qiraje financiare me Landeslease Sh.A tre vjetëshe për gjashtë makineri për një total të qirasë financiare Euro 58.450. Kjo marrëveshje është mbyllur në Qershor të vitit 2015 me kalimin e pronësisë së automjeteve tek Shoqëria. Në nëntor të 2015 është bërë një marrëveshje e re qiraje financiare për automjetet me interes Euribor 12M+7% minimumi 9.5%

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

12. HUAMARRJET (VAZHDIM)

Maturimet e detyrimeve afatgjata janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
A: Huamarrjet afatshkurtra		
Transoilgroup AG	41.762	57.615
Landeslease sh.a	1.013	1.287
	42.775	58.902
B: Huamarrjet afatgjata		
Transoilgroup AG	2.466.429	2.291.638
Landeslease sh.a	2.231	-
	2.468.660	2.291.638
	2.511.435	2.350.540

13. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme janë detyrime pa interes ndaj furnitorëve vendas dhe të huaj dhe janë të vendosura zakonisht në një periudhë që varion nga 30 deri në 180 ditë.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Ndaj furnitorëve për shpimin e puseve	-	92.171
Ndaj furnitorëve të tjerë	272.568	161.283
Të përlllogaritura për furnitorët	6.006	4.704
	278.574	258.159

14. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrimet afatshkurtra ndaj Albpetrol (shënim 11)	49.752	43.812
Sigurime shoqërore	1.600	2.420
Talimi mbi pagat	917	1.751
Ndaj punonjësve	9.280	1.400
Të tjera të pagueshme	8.080	721
	69.629	50.104

15. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar fillestar i kontribuar nga aksionarët e shoqërisë me efekt në vitin 2012 ishte 10.000 mijë Lekë.

	2015 dhe 2014		
	Numri i aksioneve	% Pronësisë	Vlera nominale në ALL'000
Transoilgroup AG - Zvicër	100'000	100%	10.000
	100'000	100%	10.000

16. TË ARDHURAT

Të ardhurat për fundin e vitit 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 përbehen nga shitjet e naftës së papërpunuar në tregun vendas dhe atë të huaj. Klientët e Shoqërisë janë Porto Romano sh.a. me 90% të shijeve të përgjithshme dhe pjesa tjetër përbëhet nga klient të tjerë vendas.

Transoildgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

17. SHPENZIME PËR MATERIALE

Shpenzimet për materiale për fundin e vitit 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Kostot e lëndës tretëse – puse	152.873	190.886
Energji elektrike	56.996	42.894
Kostot e lëndës tretëse- ne shtrese	47.049	9.285
Lëndë djegëse	32.147	20.658
Materiale te tjera	11.962	41.405
Mirëmbajtje dhe riparime – puse	10.197	-
Shpenzime qeraje	3.488	-
Taksa dhe detyrime	-	7.666
	314.712	312.794

Fusha e Visokës ka një viskozitet të lartë të naftës, e cila ka tendencë të çojë në lëvizshmëri të ulët të naftës dhe e bën të vështirë nxjerrjen e saj. Injektimi i tretësit (holluesit) ka qenë metoda kryesore e përdorur për të përmirësuar lëvizshmërinë e naftës. Tretësi i injektuar në shtresë është përdorur për të rritur lëvizshmërinë e naftës dhe për të sjellë naftën në afërsi të puseve, ku një tjetër sasi tretësi është injektuar në tubin e pusit për të lehtësuar nxjerrjen në sipërfaqe të pusit, dhe më pas në objektet e magazinimit.

18. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit për fundin e vitit 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Kostot e personelit të administrates	86.024	81.449
Kostot e personelit të prodhimit	75.354	104.588
	161.378	186.037

19. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzime të tjera për fundin e vitit 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime konsulence	48.218	43.161
Udhëtime dhe dieta	47.220	8.828
Shpenzime të tjera administrative	34.342	39.787
Shërbime ruajtje	25.000	22.198
Tarifa konsulence	12.109	22.759
Riparimi dhe mirëmbajtje	8.661	19.503
Shpenzime uji, gas dhe energji	6.963	15.769
Shpenzime qiraje operative dhe financiare	4.852	11.963
Shpenzime telekomunikacioni	3.915	3.686
Shpenzime primi sigurie	3.269	2.530
Shpenzime testimi	232	406
Bonus ndaj Albpetrol (Licencë Marrëveshjes seksioni 10.2)	(500)	3.000
Përmirësime në puse dhe në dekantim	-	56.914
	194.281	250.504

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
<i>Të ardhura të tjera</i>		
Të ardhura nga shitja	(391)	-
<i>Shpenzime të tjera</i>		
Taksa lokale	16.227	23.956
Shpenzime përfaqësimi	4.313	736
	20.149	24.692

21. TË ARDHURA FINANCIARE

Humbjet nga kurset e këmbimit, neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhurat financiare	1.155	90
Fitimet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	22.206	40.902
	23.361	40.992

22. SHPENZIMET FINANCIARE

Të ardhurat nga interesi, neto për fundin e vitit 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen :

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Humbjet nga ndryshimi i kursit të këmbimit	204.789	275.512
Shpenzimet e interesit	14.616	338
	219.405	275.850

Shpenzimet e interesit rezultojnë nga marrja me qira financiare të makinave nga Landeslease Sh.a

23. TATIM FITIMI

Norma ligjore e tatimit të shoqërisë mbi hidrokarburet është 50% për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 (2014: 50%) (shënimin 3.11). Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 Shoqëria ka një humbje nga tatimi prej 4.236.308 mijë Lekë, e cila mund të mbartet në një kohë të pacaktuar dhe të zbritet kundrejt fitimeve të ardhshme, kur dhe nëse është e mundur. Shoqëria ka vendosur opsionin të mos rregjistrojë ndonjë aktiv apo detyrim mbi tatimin e shtyrë në pasqyrat e saj financiare.

Balancat tatimore janë njohur si pozicione jashtë bilancit derisa ato të realizohen.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Humbja e periudhës para tatimit	(400,356)	(333.052)
Plus: Shpenzimet e pazbritshme	99.204	47.677
Plus: Shpenzimet PPE+PPA	5.940	23.549
Shpenzime kapitale	(1.227.540)	(1.576.725)
Fitim/(humbje) e tatueshme për vitin	(1.522.752)	(1.838.551)
Humbje të mbartura	(4.236.308)	(2.397.757)
Humbje në fund të vitit	(5.759.060)	(4.236.308)

Transoildgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

23. TATIM FITIMI (VAZHDIM)

Shpenzimet e pazbritshme janë përgjithësisht shpenzime pa dokumente mbështetëse të duhura për qëllime tatimore.

Në vitin 2015 Shoqëria ka njohur detyrime ndaj Albpertol për PPE dhe PPA në Brent për shumën 5.940 mijë Lekë, e cila është shpenzuar gjatë vitit dhe shtohet përsëri pasi sipas Marrëveshjes së Ndarjes së Hidrokarbureve është shpenzim jo i zbritshëm. Gjatë vitit 2014 Shoqëria ka reduktuar detyrimin e saj duke transferuar sipas PPE dhe PPA pjesën e naftës të Albpertol dhe duke qënë që këto kosto janë jo të zbritshme, janë shtuar përsëri për qëllime tatimore.

Humbjet tatimore të mbartura përfaqësojnë kosto hidrokarburi të parikuperuar të kryera gjatë viteve të mëparshme. Kthimet tatimore janë të paraqitura çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruar për qëllime tatimore mbeten të provizionuara derisa autoritetet (Albpertol dhe AKBN) të shqyrtojnë kthimet dhe regjistrimet e taksapaguesve dhe të lëshojnë një vlerësim final. Nafta e përfutur dhe kostot e parikuperuara janë subjekt i Ligjit të Hidrokarbureve dhe Marrëveshjes së Përbashkët të Hidrokarbureve (Referojuni shënimit 3.11).

24. PALËT E LIDHURA

Shoqëria kontrollohet nga Shoqëria mëmë Transoildgroup A.G, Zvicër, e cila ka mundësuar fondet e nevojshme për vazhdimësinë e operacioneve të hidrokarbureve.

Tabela e mëposhtme paraqet sasinë totale të transaksioneve që janë kryer me palët e lidhura për vitin përkatës financiar.

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në datën e raportimit, llogaritë e pagueshme të mëposhtme iu detyrohen palëve të lidhura:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shpenzimet dhe kostot dhe shpenzimeve të përgjithshme administrative	37.065	15.056
Detyrimet e akumuluar nga operatori i mëparshëm	3.092	3.092
Ndaj Transoildgroup AG	40.157	18.148
Detyrime ndaj Alb Drilling sh.a	1.249.142	486.240
Detyrime ndaj Bolv-Oil sh.a	146.666	30.067
Detyrimet afatgjata ndaj Porto Romano Oil sh.a	1.170.465	1.207.041
Detyrime afatshkurtër ndaj Porto Romano Oil sh.a	585.233	603.520
Ndaj administratorit	19.219	-
Ndaj palëve të tjera të lidhura total	3.170.725	2.326.868
	3.210.882	2.345.016

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata në lidhje me Porto Romano Oil sh.a kanë të bëjnë me trefësin e blerë të cilin përdoret në procesin e nxjerrjes së naftës. Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje likuidimi me Porto Romano Oil sh.a., në 3 Dhjetor 2013, ku 1/3 e pagesës do të kryhet brenda 12 muaj, dhe 2/3 do të kryhet pas 12 muajsh nga data e marrjes së faturës nga Shoqëria. Pjesa afatgjatë lidhet me 2/3 e shumës, dhe pjesa afatshkurtër e paraqitur në shënimin shpjegues 13 lidhet me 1/3 të shumës kundrejt Porto Romano Oil sh.a.

Natyra e marrëdhënies me palët e lidhura

Shoqëria ka hyrë në këto transaksione me palët e lidhura të mësipërme me kushte reciproke për të cilat është rënë dakort.

Termet dhe kushtet e transaksioneve me palët e lidhura

Shitjet dhe blerjet nga palët e lidhura janë kryer sipas çmimit normal të tregut. Balancat e mbetura ende në fund të periudhës janë të pasiguruara, pa pagesë interesi. Nuk ka asnjë garanci të dhënë ose të marrë ndaj llogarive të pagueshme ose të arkëtueshme me palët e lidhura. Më 31 Dhjetor 2015, Shoqëria nuk ka bërë ndonjë fshirje për borxhe të dyshimta me palët e lidhura (2014: zero). Ky vlerësim ndërmerret çdo vit duke ekzaminuar pozicionin financiar të palëve të lidhura dhe tregun në të cilën palët e lidhura operojnë.

Transoilgroup sh.a

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(shumat në mijë Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

25. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË

Angazhimet

Angazhime qeraje

Brenda një viti

Pas 1 por jo më shumë se 5 vjet

Më shumë se 5 vjet

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Brenda një viti	6.079	5.285
Pas 1 por jo më shumë se 5 vjet	8.995	12.320
Më shumë se 5 vjet	32.089	28.481
	47.163	46.086

Angazhimet lidhen me qiratë operative për hapësirat e zyrave dhe qirasë financiare për tokën. Sipas Marrëveshjes të Koncesionit, Shoqëria është e detyruar të shpenzojë të paktën 600,000 USD dhe të zgjerojë Planin e Vlerësimit duke përfshirë aktivitete shtesë dhe të punojë mbi puse shtesë brenda Zonës së Projektit. Plani i zhvillimit ka perfunduar në korrik të 2010-ës.

Çështjet ligjore

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështje ligjore apo ankimeve të lindura gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit.

26. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.